

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5612
E premte, 26 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Shtatorja e heroit Adem Jashari do të vendoset edhe në Mitrovicë FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ABELARD TAHIRI FAQE 4-5

Me Kodin e ri të Procedurës Penale zyrtarët me aktakuzë s'do të kenë vend në institucione



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se pas nëntë muajve punë të grupeve punuese dhe ekspertëve ndërkombëtarë, Kodi i ri i Procedurës Penale do të dërgohet në Kuvend gjatë muajit nëntor. Ai ka thënë se ndryshimi kryesor është pezullimi i zyrtarëve që kanë aktakuzë. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se qëllimi i këtij propozimi është që nëpërmjet suspendimit të këtyre zyrtarëve të parandalohet keqpërdorimi i mëtejshëm i autoritetit dhe mos t'u lihet mundësia të ndikohet në prova, element ky kyç për të siguruar ndjekje penale të suksesshme. Ai është shprehur i bindur se do ta gjejë

mbështetjen e nevojshme nga shumica e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës për aprovimin e këtij kodi. "Tekefundit, këto janë interesa të shtetit dhe të shoqërisë, si dhe obligime që Kosova ka marrë përballë MSA-së, Agjendës së Reformave Evropiane dhe procesit integruar", ka deklaruar Tahiri

Shoqata Atdhetare 'Kosova' e ndihmoi Kosovën me miliona marka

Kryetari i Shoqatës Atdhetare Gjermano-Shqiptare "Kosova", Avdi Fejzaj, ka treguar se me përkrahjen e mërgatës dhe donatorëve gjermanë kjo shoqatë ka ndihmuar Kosovën gjatë luftës çlirimtare me miliona marka. Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re" ai ka treguar se shifrat financiare të ndihmës së organizatës kanë qenë deri në 16 milionë marka. Fejzaj ka shpalosur edhe dokumentacionin e hyrjeve dhe daljeve të shumave financiare që kanë qenë të destinuara për UÇK-në dhe për qëllimet e tjera FAQE 7



Lirohet Jahir Demaku, por jo edhe Sylejman Selimi FAQE 6

AKTUALE



KRYEZIU: KALIMI I LIGJEVE PA IMPUTIN E OPOZITËS DËMTON QYTETARËT, JO QEVERINË F. 3

PERSPEKTIVA EVROPIANE E KOSOVËS, E PADISKUTUESHME F. 3

VESELI: MJEKËT DHE STAFI SHËNDETËSOR NGA VITI I ARDHSHËM DO TA MARRIN PAGËN ME RITJE F. 6

EKONOMI

MIRATOHET NË PARIM PROJEKTIGJI PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK F. 3

KËRKOHET VËMENDJE INSTITUCIONALE PËR PROJEKTIGJET EKONOMIKE F. 9

SPORT

FLAMURTARI SYNON TA SHLYEJË SERINË E ZEZË NDAJ FERIZAJT F. 14

'PRISHTINA' ME PENALLTI E MPOSHTI 'BARDHOSH GËRVALLËN' F. 14

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Lekaj anulon vizitën në Graçanicë në mungesë të simboleve shtetërore

PRISHTINË, 25 TETOR - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka refuzuar ta zhvillojë vizitën e paralajmëruar në Komunën e Graçanicës, me të marrë vesh se kjo e fundit ka refuzuar t'i vendosë simbolet shtetërore të

Republikës së Kosovës në hapësirat ku parashihej të mbahet takimi. "Për Lekajn dhe kabinetin e tij është e papranueshme të gjenden në një institucion që nuk identifikohen me simbolet e shtetit që

i përkasin, Republikës së Kosovës. I pari i Infrastrukturës do të jetë edhe më tutje afër qytetarëve të kësaj komune, duke paraparë edhe projekte konkrete infrastrukturore për plotësim të nevojave të tyre",

është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Ministri Lekaj ka falënderuar mediet që shprehën gatishmërinë që të përcjellin këtë aktivitet dhe ka kërkuar mirëkuptimin e tyre.



Haradinaj takohet me Gjukanoviçin, flasin për bashkëpunimin mes dy shteteve

Gjatë takimit me presidentin malazias, Milo Gjukanoviç, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar raportet e mira bilaterale që Kosova ka me Malin e Zi, duke theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në fusha të tjera të interesit të përbashkët, që ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë

BUDVË, 25 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë pjesëmarrjes në Konferencën për Ekonomi, në kuadër të Procesit të Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor që po mbahet në Budvë, të enjten është takuar me presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç.

Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar presidentin Gjukanoviç për angazhimin e Qeverisë për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, zhvillimin ekonomik, progresin e Kosovës në rrugën euroatlantike, si dhe për rëndësinë e anëtarësimit në Interpol dhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare.

Gjatë takimit kryeministri Haradinaj ka vlerësuar raportet e mira bilaterale që Kosova ka me Malin e Zi, duke theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në fusha të tjera të interesit të përbashkët, që ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë. Po ashtu, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar presidentin e Malit të Zi edhe me procesin e transformimit të FSK-së në ushtri dhe miratimin nga Kuvendi të tri ligjeve për FSK-në, duke theksuar se kjo është një e drejtë sovraane.

Në fokus të takimit ka qenë edhe tema e dialogut, për të cilin

kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova është e gatshme për një marrëveshje ligjore obligative me Serbinë, që do të thotë njohje reciproke, me detyrimin që Serbia të mos e pengojë Kosovën të bëhet anëtare e OKB-së dhe të bashkohet me mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Haradinaj: Kosova ofron mundësi të shumta për investime

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë në Konferencën e Ekonomisë, Ballkani dhe Bashkimi Evropian - Cikli pesëvjeçar i Procesit të Berlinit. Kryeministri Haradinaj ishte pjesë e panelit, ku u diskutua për perspektivën ekonomike dhe evropiane të Ballkanit së bashku me kryeministrin e Malit të Zi, Dushko Markoviç, ministrin për Çështje Ekonomike të Maqedonisë, Kocho Angjushev dhe zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Tregtisë të Serbisë, Rasim Ljajic. Kryeministri Haradinaj tha se Kosova ofron mundësi të shumta për investime, duke përfshirë lehtësira fiskale dhe infrastrukturore të konsoliduar. Haradinaj theksoi se



Kosova është e hapur për të gjitha vendet e rajonit dhe ekziston një bashkëpunim i mirë me vendet fqinje. Në raport me Serbinë, kryeministri Haradinaj tha se ekonomia e Serbisë tashmë e ka njohur Kosovën dhe

do të ishte mirë që edhe politika e këtij shteti fqinj ta bënë këtë sa më shpejtë. Në raport me CEFTA-n, Kosova ka marrë të gjitha obligimet ndërkombëtare kur ka qenë e përfaqësuar bashkë me UNMIK-un, por

është e rëndësishme që të kuptohet se nga viti 2008 Kosova është shtet sovran dhe i pavarur dhe vetëm si e tillë Kosova do të përfaqësohet në këtë organizatë dhe në dokumentet e marrëveshjet e ardhshme.

Kuvendi miraton mbylljen e lojërave të fatit

TIRANË, 25 TETOR - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka aprovuar me shumicë votash Ligjin për lojërat e fatit, me anë të së cilit pas 31 dhjetorit të këtij viti ndalohet kjo veprimtari. Miratimin e këtij ligji e ka përshëndetur kryeministri i vendit,

Edi Rama.

"Kuvendi sapo miratoi me 100 për qind të deputetëve të pranishëm ndalimin e bixhozit (kazino elektronike dhe baste të çdo lloji off apo online) në 31 dhjetor. Fjalët mbrapsht shpifësve të çdo kanali e portali,

ndërsa me aktorët e Kinoshqypit kemi dhe gjyqet se do paguajnë një më një ata", ka shkruar Rama në llogarinë e vet në "Twitter". Po ashtu, Parlamenti ka rrëzuar dekretin e presidentit Ilir Meta për Teatrin Kombëtar.

Mazhoranca rrëzoi me 74 vota dekretin presidencial. Ndërkohë ministri i Diasporës, Pandeli Majko edhe në këtë seancë nuk ka marrë pjesë në votim.

Me votimin e së enjtes, mazhoranca hap rrugën për shembjen



e godinës ekzistuese të Teatrit Kombëtar.

Kryeziu: Kalimi i ligjeve pa imputin e opozitës dëmton qytetarët, jo Qeverinë

PRISHINË, 25 TETOR (ER) - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se grupet parlamentare, duke bojkotuar seancat e Kuvendit, po e humbasin mundësinë që politikën dhe idetë e partive që përfaqësojnë t'i reflektojnë në ligjet dhe përditshmërinë e qytetarëve që adresohen nëpërmjet këtyre ligjeve. Ai ka theksuar se nuk është i

mjaftueshëm vetëm kontributi dhe pjesëmarrja në komisionet parlamentare. "Prej partive politike të skenës kosovare, aktivitet politikbërës është duke zhvilluar vetëm PSD-ja përmes grupit të vet parlamentar. Grupet parlamentare, duke bojkotuar seancat e Kuvendit, po e humbasin mundësinë që politikën dhe idetë e partive që përfaqësojnë t'i reflektojnë në ligjet dhe përditshmërinë e qyte-

tarëve që adresohen përmes këtyre ligjeve. Nuk është e mjaftueshme vetëm kontributi dhe pjesëmarrja në komisionet parlamentare", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas Kryeziut, kalimi i ndonjë ligji pa imputin e opozitës më shumë e dëmton jetën e qytetarëve sesa Qeverinë. "Ndërsa bojkotimi i sesioneve plenare dhe mospjesëmarrja në votimin e ligjeve nuk është

strategji që rezulton me rrëzimin e Qeverisë. Kosova ka aq ligje saqë jo vetëm kjo Qeveri, por secila Qeveri me lehtësinë më të madhe mund të veprojë. Ndaj jodomsoshmërisht disa ligje mund t'ia cenojnë vendimmarrjen dhe funksionimin Qeverisë. Mungesa e ndonjë iniciative ligjore, apo kalimi i ndonjë ligji pa imputin e opozitës, më shumë e dëmton jetën e qytetarëve sesa Qeverinë!", është shprehur Kryeziu.



Perspektiva evropiane e Kosovës, e padiskutueshme

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, mori pjesë të enjten në debatin e Asociacionit të Parlaenteve Evropiane në Strasburg. "Politika e zgjerimit të BE-së duhet të shihet si një mekanizëm për ta bërë familjen e BE-së më të plotë dhe më të qëndrueshme", ka deklaruar ministrja Hoxha

"Përfshirja e më shumë vendeve në familjen evropiane do t'u mundësojë që këto vende të arrijnë jo vetëm reformat në ekonomi, por edhe fuqizimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit. Politika e zgjerimit të BE-së duhet të shihet si një mekanizëm për ta bërë familjen e BE-së më të plotë dhe më të qëndrueshme", ka deklaruar ministrja Hoxha, duke shtuar se pret që kjo të riafirmohet nga institucionet e BE-së, si dhe për ta gjithë rajonin, një perspektivë dinamike, konkrete dhe të arritshme. "BE-ja ka rregullat e veta për pranimin

dhe vendet e Ballkanit kanë ende punë për të bërë me reforma thelbësore që prekin sektorët më të rëndësishëm", është shprehur Hoxha. Ajo ka potencuar se BE-ja duhet të jetë në gjendje t'i vlerësojë në mënyrë objektive arritjet dhe të japë vendim në përputhje me rrethanat dhe meritat. "Anëtarësimi në BE i vendeve të Ballkanit do të kishte një ndikim pozitiv edhe në politikën kombëtare të shteteve duke absorbuar praktikën më të mira dhe vlerat evropiane", është shprehur Hoxha.

Gjatë presidencës austriake Kosova pret që të mbyllet procesi i vendimmarrjes për liberalizimin e vizave, kur dihet se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në udhërrëfyesin dhe kjo është konfirmuar nga Komisioni Evropian. "Qytetarët tanë besojnë në vlerat evropiane, duke ndjekur rregullat dhe vlerat integruese. Gjatë presidencës austriake presim mbështetje të pakursyer, veçanërisht për reformat e ndërmarra, të pasqyruara në strategjitë e përbashkëta tashmë të miratuara", ka theksuar ministrja Hoxha.

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

STRASBURG, 25 TETOR - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, mori pjesë në debatin e Asociacionit të Parlaenteve Evropiane në Strasburg, ku mba-

ji fjalë rasti dhe ceku perspektivën e Kosovës brenda proceseve integruese evropiane.

Ministrja Hoxha ka shprehur bindjen se pjesa më e rëndësishme ku BE-ja duhet ta përqendroj politikën e saj të jashtme është procesi i zgjerimit.



Miratohet në parim Projektligji për pagat në sektorin publik

PRISHINË, 25 TETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës në vazhdimin e seancës, e cila është mbajtur të enjten me 62 vota për, 2 abstenime dhe asnjë kundër, kanë miratuar në parim Projektligjin për pagat në sektorin publik. Deputetët kanë miratuar edhe këto projektligje: Projektligjin për plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Projektligjin për ratifikimin e traktatit që themelon komunitetin e transportit, Projektligji për

plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave, Projektligji për tatimin në të ardhurat personale. Në parim u miratuan edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, Projektligji për Inspektoratin e Punës, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit, Projektligji për organizimin

dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Projektligji për zyrtarët publikë. Gjatë formimit të Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb, nënkryetarja e Kuvendit, Myfëra Shinik, e ka mbyllur seancën duke thënë se administrata do të lajmërojë për vazhdimin e saj. Edhe në këtë seancë ka pasur mungesë të deputetëve dhe nuk



kapasur kuorum për të vazhduar. Deputetët e LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje vetëm në fillim të

seancës kanë marrë pjesë në miratimin e disa projektligjeve, pastaj e kanë lëshuar seancën.

Flet për "Epokën e re", Abelard Tahiri

Me Kodin e ri të Procedurës Penale zyrtarët me aktakuzë s'do të kenë vend në institucione

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se pas nëntë muajve punë të grupeve punuese dhe ekspertëve ndërkombëtarë, Kodi i ri i Procedurës Penale do të dërgohet në Kuvend gjatë muajit nëntor. Ai ka thënë se ndryshimi kryesor është pezullimi i zyrtarëve që kanë aktakuzë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se qëllimi i këtij propozimi është që nëpërmjet suspendimit të këtyre zyrtarëve të parandalohet keqpërdorimi i mëtejshëm i autoritetit dhe mos t'u lihet mundësia të ndikohet në prova, element ky kyç për të siguruar ndjekje penale të suksesshme. Ai është shprehur i bindur se do ta gjejë mbështetjen e nevojshme nga shumica e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës për aprovimin e këtij kodi. "Tekfundit, këto janë interesa të shtetit dhe të shoqërisë, si dhe obligime që Kosova ka marrë përballë MSA-së, Agjendës së Reformave Evropiane dhe procesit integruar", ka deklaruar Tahiri

EPOKA E RE **Shqipëri HETEMI**

PRISHTINË, 25 TETOR -

"Epoka e re": Ministër Tahiri, ju keni deklaruar që ndër prioritet tuaja në vitin 2018 është rishikimi i Kodit të Procedurës Penale. A mund të na tregoni nëse është duku u punuar në këtë proces?

Tahiri: Është e vërtetë që këtë vit kemi pasur një dinamikë jashtëzakonisht të madhe për sa i përket propozimit dhe hartimit të politikave ligjore të fushës së drejtësisë. Si ministri prijmë në nivel të Qeverisë në aspektin e përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve. Megjithatë, përtej realizimit të zakonshëm të agjendës apo programit qeveritar, nën reflektimin e nevojës që politikave penale të rishikohen për t'i adresuar sfidat e ndryshme të identifikuar nga procesi i zbatimit të ligjeve në fuqi, pas hartimit të Kodit të ri Penal dhe dy pakove të rëndësishme ligjore, prej gati nëntë muajsh jemi duke punuar në rishikimin e Kodit të Procedurës Penale. Gjatë muajit nëntor do të finalizohet dhe i njëjti do të dërgohet në procedura të rregullta të konsultimeve.

"Epoka e re": Deri në çfarë mase ka shkuar rishikimi i këtij Kodi?
Tahiri: Grupet punuese kanë mbajtur takime të vazhdueshme dhe, çfarë është më e rëndësishmja, rezultatet nuk kanë munguar.

Janë dhënë propozime për plotësimin dhe ndryshimin e neneve të Kodit aktual të Procedurës Penale, ku prej 547 neneve sa ka gjithsejtë ky Kod, janë bërë ndërhyrje, përkatësisht propozime për amendamentimin e mbi 220 neneve, propozime këto për të cilat është diskutuar në grupin e madh punues, i cili ka vendosur për këto propozime. Në takimet e nëngrupeve punuese, përveç propozimeve për plotësim-ndryshim të neneve ekzistuese të cilat kanë paraqitur probleme

në zbatim, ka pasur propozime edhe për inkorporimin e neneve të reja lidhur me çështjet të cilat kanë rezultuar si të nevojshme nga aktorët relevantë të praktikës gjyqësore. Po ashtu, janë dhënë propozime nga përfaqësuesit ndërkombëtarë lidhur me harmonizimin e Kodit të Procedurës Penale me praktikën më të mira të vendeve të BE-së të cilat pritet që të përfshihen me dispozita më të qarta për sa iu përket çështjeve procedurale - penale në raport me harmonizimin e të drejtës së BE-së



duke bërë që ky kod të jetë më efikas dhe më përmbajtjesor rreth dukurive negative në sistemin e drejtësisë penale.

"Epoka e re": Cilat janë disa prej çështjeve më të rëndësishme që janë trajtuar dhe janë ndryshuar?

Tahiri: Çështjet kryesore të plotësuar dhe ndryshuara janë: 1. Heqja e dëgjimit të dytë. Është propozuar që të fshihet seanca e dytë, me arsyetimin se në praktikë asnjë seancë e dytë nuk është duke u mbajtur. Të gjitha kërkesat për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave bëhen me shkrim. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues lëshon një vendim me shkrim për të vendosur mbi kërkesat e tilla. Ky ndryshim është bërë në mënyrë që të thjeshtësohet faza e aktakuzës. 2. Afati i hetimeve është zgjatuar. Periudha kohore e hetimit në parim është dy vjet, por mund të zgjatet nga gjyqtari i procedurës paraprake çdo gjashtë muaj për një periudhë maksimale prej dy vjetësh. Pra, koha e hetimit mund të zgjatet deri në një maksimum të

mundshëm prej katër vjetësh nën disa rrethana specifike. Ky ndryshim është bërë për shkak se afati aktual për hetim konsiderohet të jetë një afat shumë i shkurtër, veçanërisht për veprat penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ky ndryshim i jep më shumë fleksibilitet sistemit kur është e nevojshme. Gjyqtari i procedurës paraprake do të kishte diskrecionin për ta miratuar zgjatjen e hetimeve çdo gjashtë muaj, deri në një total prej katër vjetësh. 3. Janë bërë ndryshime që lidhen drejtpërdrejt me procedurat e konfiskimit. Janë ndryshuar të gjitha dispozitat në lidhje me konfiskimin sepse ka pasur ankesa se procedurat aktuale të konfiskimit janë shumë të komplikuar dhe zbatuesit kanë hasur shumë vështirësi në zbatimin e tyre. Nenet e ndryshuara janë në pajtim me Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. 4. Shtimi i dispozitave të reja lidhur me pezullimin e zyrtarëve të lartë publikë për të cilët është shpallur aktgjykim dënues lidhur me veprat penale të keqpërdorimit të detyrës



zyrtare dhe korrupsionit. Qëllimi i këtij propozimi është që përmes suspendimit të këtyre zyrtarëve të parandalohet keqpërdorimi i mëtejshëm i autoritetit dhe mos t'u lihet mundësia të ndikohet në prova, element ky kyç për të siguruar ndjekje penale të suksesshme. Nenet e propozuara vlejné për të gjithë personat zyrtarë të akuzuar për veprat penale të korrupsionit, duke mundësuar kështu trajtimin dhe qasjen uniforme ndaj tyre pa marrë parasysh funksionin ose detyrat që mund të ushtrojnë. 5. Është shtuar nen i ri lidhur me gjykimin në mungesë i cili përcakton se nëse i pandehuri i cili vullnetarisht dështon të paraqitet në seancë gjyqësore pasi të jetë informuar për datën, nuk duhet të lejohet ta vonojë procedurën. Në ato raste kur prokurori nuk mund të gjejë një të pandehur pas përpjekjeve të arsyeshme, gjykimi duhet të jetë në gjendje të mbahet sipas rrethanave të propozuara në këtë nen. Propozimi ka ardhur për shkak se ka shumë raste kur ka pasur vështirësi për sigurimin e pranisë së të pandehurit në

procedurë, me ç'rast të pandehurit i janë shmangur drejtësisë e sidomos për krimet më të rënda siç janë krimet e luftës. Përveç kësaj, mungesa e të pandehurit në gjykim ka shkaktuar edhe shpenzime të mëdha si dhe ka rezultuar pa një vendim final nga ana e gjykatës. Ky rregullim ekziston në disa prej vendeve të regjionit. Gjykimi në mungesë është evituar në Kosovë si arsyetim i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sepse është konsideruar se gjykimi në mungesë është shkelje e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, bazuar në standardet dhe direktivat e BE-së, instituti i gjykimin në mungesë nuk është shkelje e të drejtave të njeriut nëse plotësohen disa kushte dhe kriteret.

Gjithashtu, ky propozim për gjykimin në mungesë është në harmoni me Direktivën e BE-së 2016/343 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 9 marsit 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor përveç veprave penale të cilat nuk parashkruhen. 6. Janë plotësuar masat për ta

lehtësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose të viktimave në lidhje me peshën e veprës penale (harmonizimi me direktivat e BE-së). 7. Janë bërë plotësime në dispozitat lidhur me të drejtat e viktimave apo palëve të dëmtuara. Ndryshimet e këtyre neneve i japin më shumë të drejta palës së dëmtuar apo viktimës, siç është e drejta për të marrë informata në lidhje me veprën penale, të drejtën për të marrë informata për ofrimin e ndihmës mjekësore, përkrahjes psikologjike, strehimit alternativ dhe të drejtave të tjera që lidhen me interesin e tyre juridik. 8. Gjithashtu është shtuar një nen i ri, që lidhet me seancën për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë apo aktgjykimin të tillë është ta lejohet zbatimin e udhëzuesit të dënimeve dhe t'u mundësojnë palëve që t'i argumentojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në një seancë të veçantë. Ka pasur shqetësime se mbrojtja nuk argumenton rrethanat lehtësuese në fjalën përfundimtare kur i pandehuri nuk e pranon fajin për shkak se ata frikësohen se diçka e tillë

mund të nënkuptohet si pranim i fajësisë. Prandaj, mundësi mi i një seance dëgjimore, pasi personi është shpallur fajtor, ua jep mundësinë të dyja palëve t'i bëjnë argumentet e tyre lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. 9. Janë bërë edhe ndryshime në kapitullin e masave të fshehta. Pothuajse i gjithë kapitulli i masave të fshehta është ndryshuar sepse nenet aktuale kanë paraqitur vështirësi në aspektin e zbatimit praktik për shkak të mungesës së qartësisë dhe mospërputhjeve ndërmjet neneve. Ndryshimet e reja lejojnë më shumë fleksibilitet për prokurorin që t'i zbatojë këto masa. Masat të cilat e shkelin seriozisht privatësinë e personit lëshohen nga gjykata, ndërsa masat e tjera lëshohen nga prokurori. 10. Janë rishikuar edhe nenet për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues. Ndryshimet e reja në këto nene i japin më shumë fleksibilitet prokurorit për t'i zbatuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë. Sipas këtyre ndryshimeve, procedura për marrëveshjet për pranim të

fajësisë dhe dëshmitarëve bashkëpunues është shumë më e thjeshtë dhe më e lehtë për t'u zbatuar në praktikë dhe me shpresë do ta inkurajojë zbatimin e nenit lidhur me dëshmitarët bashkëpunues për të zhvilluar prova në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

"Epoka e re": Si ministri dhe sponsorues i këtij Kodi, a keni hasur në pajtueshmëri me të gjitha propozimet e bëra nga këto grupe punuese, kur dihet se përbërja e grupeve punuese është shumëpalëshe?

Tahiri: Përballë qëndrimeve dhe propozimeve të ndryshme, në disa raste edhe të kundërta për disa çështje, nuk mund të vihet në pyetje qëllimi dhe vullneti ynë si sponsore, por edhe i ekspertëve dhe institucioneve të tjera të përfshira. Sigurisht se ka pasur debate e diskutime të ndryshme dhe interesante. Për shembull, disa prej çështjeve të cilat kanë qenë, po themi kontestuese, e të cilat do të vendosen mbi bazën e shumësisë së argumenteve, janë: E para, çështja e publicitetit të aktakuzave, pastaj çështja e kufizimeve të provave, apo për kushtet për revokimin e dënimeve alternative. Pastaj është diskutuar edhe për mundësinë e rikthimit të Policisë Gjyqësore, po ashtu edhe për mjetet juridike dhe disa aspekte të tjera të cilat ditët në vijim do të vendosen përfundimisht.

"Epoka e re": Z. Tahiri, për të gjitha këto propozime dhe ndryshime që janë bërë, a prisni mbështetje edhe në Kuvendin e Kosovës?

Tahiri: Detyrë imja është që kjo punë serioze që kemi bërë dhe është duke u vazhduar të kanalizohet si një kontribut për avancimin e sistemit të drejtësisë. Jam i prirë të besoj se reformat e tilla do ta gjejnë mbështetjen e nevojshme nga shumica e grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Tekefundit, këto janë interesa të shtetit dhe të shoqërisë si dhe obligime që vendi ynë i ka marrë përballë MSA-së, Agjendës së Reformave Evropiane dhe procesit integruar.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet tuaja nga ky projektкод?

Tahiri: Jam optimist dhe mirëpres rezultatet e mira, sepse përmes miratimit të projektkodit të Procedurës Penale dukshëm pritet të rritet efikasiteti dhe transparenca si dy sfida kryesore të sistemit të drejtësisë, si dhe do të ndikojë në qasjen më të mirë në drejtësi dhe ngritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor dhe sektorin e drejtësisë në përgjithësi, përfshirë krijim të kushteve për luftim më të mirë të korrupsionit përmes rishikimit të proceduarave që zbatohen organet e drejtësisë.

Lirohet Jahir Demaku, por jo edhe Sylejman Selimi

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Gjykata Supreme e Kosovës ka liruar me kusht Jahir Demakun, ndërsa është hedhur poshtë kërkesa për lirim për Sylejman Selimin. Lajmin e ka bërë me dije të enjten avokati i Selimit, Tomë Gashi. "Qartas në mënyrë të kundërligjshme dhe pa vendim gjyqësor për 136 ditë, Gjykata Supreme e Kosovës po e mban në

burg Sylejman Selimin", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se edhe tentimi i së enjtes për ta liruar me kusht Sylejman Selimin dështoi pasi që nuk pati vullnet politik të atyre që thirren në drejtësi. "Për çka keni luftuar ju ushtarë dhe komandantë të UÇK-së. Që të kemi sistem të këtyllë juridik, që të mbajnë mbi pesë vjet në burg me prova të

montuara. Dhe për 136 ditë pa asnjë vendim gjyqësor ta mbajnë në burg komandantin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, gjeneral Sylejman Selimin. Nuk besoj se keni luftuar për kësi sistemi të korruptuar juridik deri në palcë. Paneli për lirim me kusht sot e liroi Jahir Demakun, por jo Sylejman Selimin... a thua pse?", ka thënë avokati Gashi.



Shtatorja e heroit Adem Jashari do të vendoset edhe në Mitrovicë

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

MITROVICË, 25 TETOR - Të enjten është mbajtur mbledhja e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, të cilën e ka udhëhequr Jeton Ujkani, kryesues i Kuvendit të Komunës, në të cilën, përveç këshilltarëve të Kuvendit Komunal, ishin të pranishëm edhe drejtorët e drejtorive komunale. Para se të votohej rendi i ditës, kryesuesi Ujkani ka propozuar një pikë të re e që ishte propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ndërsa asamblisti i grupit parlamentar i PDK-së, Donjet Bislimi, ka propozuar që në takim të diskutohet edhe për vendosjen e shtatores së komandantit Adem

Jashari në Komunën e Mitrovicës.

Të dyja propozimet u miratuan nga këshilltarët e Kuvendit Komunal.

Në vazhdim këshilltarët e Kuvendit Komunal aprovuan me shumicë votash propozimvendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2018/2019;

Propozimvendimin për formimin e Komisionit për hartimin e planit të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2019; Planin e caktimit të pikave të grumbullimit të mbeturinave; Propozimvendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Këshilltarët në këtë mbledhje aprovuan konkluzionin për ndërtimin e shtatores të heroit legjendar Adem Jashari në qytetin e Mitrovicës.



Tahiri: Miratimi në parim i pakos së administratës shtetërore hap shtigje të reja për reforma



PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë se miratimi në parim i pakos së administratës shtetërore në Kuvendin e Kosovës hap shtigje të reja për reforma duke përfshirë edhe fuqizimin e nivelit lokal. Tahiri përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky është një veprim i veçantë edhe në fushën e reformës së administratës publike, duke kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës Pakoja e Reformës (Projektligji për Pagat në Sektorin Publik; Projektligji për Organizimin

dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe Projektligji për Zyrtarët Publikë).

Tahiri ka thënë se kjo pako në tërësi është themel i qëndrueshëm për një administratë shtetërore efektive dhe funksionale që do të kthehet në promotor të zbatimit të ligjit, zhvillimit ekonomik dhe synimeve të përbashkëta integrale. "Me përfundimin e kësaj pakoje hapen shtigje të reja për reforma, njëkohësisht mundësi më të mëdha për ta fuqizuar qeverisjen lokale në të gjitha aspektet", ka deklaruar Tahiri.

Veseli: Mjekët dhe stafi shëndetësor nga viti i ardhshëm do ta marrin pagën me rritje

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të enjten në takim drejtuesit e Sindikatës së Shëndetësisë. Gjatë këtij takimi Veseli ka thënë se mjekët dhe i gjithë stafi shëndetësor nga viti i ardhshëm do ta marrin pagën me rritje. "Gjatë diskutimit që

pata sot me drejtuesit e Sindikatës së Shëndetësisë, konfirmova se me një pako fiskale dhe Ligjin për Buxhetin 2019 do të përfshihet kjo rritje, por edhe investime të tjera që transformojnë gjendjen në sektorin e shëndetësisë. Po ashtu, do t'i përgjigjemi një shqetësimi të infermierëve të

ngritur nga kjo sindikatë. Shëndetësinë e kemi prioritet. Dua ta përgëzoj ministrin Uran Ismaili dhe gjithë stafin shëndetësor për punën që kanë bërë dhe po bëjnë për kthimin e besimit të qytetarëve tanë në shërbimet publike shëndetësore", ka deklaruar Veseli pas takimit.



Flet për "Epokën e re", Avdi Fejzaj

Shoqata Atdhetare 'Kosova' e ndihmoi Kosovën me miliona marka

Kryetari i Shoqatës Atdhetare Gjermano-Shqiptare "Kosova", Avdi Fejzaj, ka treguar se me përkrahjen e mërgatës dhe donatorëve gjermanë kjo shoqatë ka ndihmuar Kosovën gjatë luftës çlirimtare me miliona marka. Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re" ai ka treguar se shifrat financiare të ndihmës së organizatës kanë qenë deri në 16 milionë marka. Fejzaj ka shpalosur edhe dokumentacionin e hyrjeve dhe daljeve të shumave financiare që kanë qenë të destinuar për UÇK-në dhe për qëllimet e tjera

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 TETOR - Kryetari i Shoqatës Atdhetare Gjermano-Shqiptare "Kosova", Avdi Fejzaj, ka bërë me dije se para luftës dhe gjatë luftës ka ndihmuar Kosovën përmes kësaj shoqate me mijëra tona ndihma dhe miliona marka gjermane. Ai ka treguar se këtë e ka arritur falë përkrahjes së madhe të mërgatës shqiptare dhe disa organizatave humanitare gjermane. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Fejzaj kapërmendur edhe shifra se sa ka qenë ndihma që kjo shoqatë i ka ofruar Kosovës. "Në bazë të faturave dhe llogaritjeve tona, shuma e ndihmave që kemi ofruar si shoqatë me ndihmën e donatorëve ka qenë rreth 16 milionë marka gjermane", ka thënë Fejzaj.

Humanisti Fejzaj ka folur edhe për ndihmën financiare që kjo shoqatë ka grumbulluar për luftën çlirimtare në Kosovë. "Në atë periudhë të rend për vendin tonë, Shoqata Gjermano-Shqiptare, në një prej mbledhjeve të kuvendit të vet, ka marrë vendim që ta ndërmarrë aksionin për grumbullimin e mjeteve financiare për UÇK-në, për ta ndihmuar luftën e saj. Kështu që, përmes Fondit të Republikës së Kosovës, brenda gjashtë muajve, kemi arritur t'i mbledhim dhe t'i destinojmë për UÇK-në 1.5 milion marka. Kjo ka ndodhur në shkurt të vitit 1999",

është shprehur Fejzaj.

Më tej, ai ka shpalosur gjithë dokumentacionin e hyrjeve dhe daljeve të ndihmave të destinuar për Kosovë gjatë luftës. "Ne e kemi mbështetur Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë në Kosovë me vlerë prej 400 mijë markash gjermane. Është ndihmuar me mjete të grumbulluara financiare edhe 'Dardania Bankë' në Tiranë, ndërsa rreth 100 mijë marka janë ndarë për nevoja emergjente. Janë dhënë mjete materiale të gatshme edhe për Universitetin e Prishtinës, ndërkohë Unionit të Studentëve i është ndihmuar me 25 mijë markash, sikurse që është ndihmuar edhe Fakulteti i Mjekësisë me 48 mijë marka. Të gjitha këto shifra që po i përmendi i kam të dokumentuar këtu, ku vetë përfaqësuesit e universitetit, të studenteve dhe ish të burgosurve politikë na i kanë konfirmuar me shkrim se i kanë pranuar", ka deklaruar ai.

"Epoka e re": Z. Fejzaj, kur ka filluar veprimtarinë Shoqata Bamirësie Atdhetare Gjermano-Shqiptare me seli në Olsberg të Gjermanisë, të cilën e udhëhoqeni?

Fejzaj: Në vitin 1995 ka filluar veprimtarinë humane e bamirëse Shoqata Atdhetare Gjermano-Shqiptare "Kosova" me seli në Olsberg të Gjermanisë, për ta vazhduar aktivitetin edhe pas çlirimit të Kosovës. Aktivitetin më të dendur kjo shoqatë e ka zhvilluar



gjatë kohës së luftës në Kosovë.

"Epoka e re": Si iu përgjigj aktivitetit të kësaj shoqate mërgata shqiptare?

Fejzaj: Mërgata shqiptare e ka mirëpritur aktivitetin tonë, duke u bashkuar në grumbullimin e ndihmave gjithandë Evropës, pa dallime partiake, fetare apo grupe të tjera. Të gjitha ndihmat që i grumbullonin degët dhe nëndegët i depononim në depon e selisë së shoqatës në Olsberg të Gjermanisë duke bashkëpunuar edhe me Caritasin Internacional të Vjenës.

"Epoka e re": Kur filluat t'i nisni ndihmat e para për Kosovë dhe, pos mërgatës shqiptare, kush tjetër ju mbështeste?

Fejzaj: Nga 15 janari i vitit 1996 ndihmat filluan të shkonin në qendrën e Shoqatës "Nëna Tereza" në Prishtinë. Kjo periudhë zgjati dy vjet, deri në mars të vitit 1998. Sipas dëshmimeve të dokumentacionit dhe faturave me numra, totali i përgjithshëm i

ndihmave ishte 580 tonë, ndërsa vlera e kësaj ndihme ishte 6 milionë e 200 mijë marka gjermane. Donatore kryesore e këtyre ndihmave fillestare ishte Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste, Diagonia-Socialo-Caritaset e qytetarëve, Kryqi i Kuq gjerman dhe mërgata shqiptare në gjermani. Të gjithë këta donatorë kanë qenë bashkëpunëtorë të Shoqatës Gjermano-Shqiptare. Pastaj, gjendja e rëndë që mbretëronte në Kosovë, ku pjesa dërrmuese e popullatës u zhvendos në Shqipëri, bëri që kjo shoqatë ta vazhdojë aktivitetin human e bamirës në qytetet e ndryshme të Shqipërisë, në bashkëpunim me shoqatën vendëse të Tiranës "Ulpiana".

"Epoka e re": Me çfarë i ndihmonit të zhvendosurit në Shqipëri?

Fejzaj: Gjatë viteve 1998-1999 popullata është ndihmuar me 14 maune me artikuj ushqimorë, veshmbathje dhe artikuj të tjerë. Në ndërkohë është ndihmuar edhe Shqipëria nga Shoqata

Gjermane "Allgemeine Soziale Beratung" nga Briloni. Ndihmat me artikuj ushqimorë ishin 120 tonë, medikamente dy tonë, derisa ato ndihma i kemi dërguar në Kryqin e Kuq të Shqipërisë përmes Caritasit Internacional të Vjenës. Donatorët që ndihmonin me mjete materiale dhe financiare ishin edhe institucionet humanitare gjermane. Ndërsa për transportin e ndihmave kontribut të veçantë ka dhënë Caritasi i Vjenës, që ishte i njohur për transportin e ndihmave humanitare në Shoqatën "Nëna Tereza" në Prishtinë.

"Epoka e re": Ju edhe financiarisht keni ndihmuar disa institucione dhe luftën e UÇK-së. A mund të na flisni pak për këtë çështje?

Fejzaj: Natyrisht. Ne kemi mbështetur Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë në Kosovë me vlerë prej 400 mijë markash gjermane. Është ndihmuar me mjete të grumbulluara financiare edhe 'Dardania Bankë' në Tiranë, ndërsa rreth 100 mijë marka janë ndarë për nevoja emergjente. Janë dhënë mjete materiale të gatshme edhe për Universitetin e Prishtinës, ndërkohë Unionit të Studentëve i është ndihmuar me 25 mijë markash, sikurse që është ndihmuar edhe Fakulteti i Mjekësisë me 48 mijë marka. Të gjitha këto shifra që po i përmendi i kam të dokumentuar këtu, ku vetë përfaqësuesit e universitetit, të studenteve dhe ish të burgosurve politikë, na i kanë konfirmuar me shkrim se i kanë pranuar këto shuma të të hollave.

"Epoka e re": Po për UÇK-në, sa të holla keni dërguar?

Fejzaj: Në atë periudhë të rëndë për vendin tonë, Shoqata Gjermano-Shqiptare, në një prej mbledhjeve të kuvendit të vet, ka marrë vendim që ta ndërmarrë aksionin për grumbullimin e mjeteve financiare për UÇK-në, për ta ndihmuar luftën e saj. Kështu që, përmes Fondit të Republikës së Kosovës brenda gjashtë muajve kemi arritur t'i mbledhim dhe t'i destinojmë për UÇK-në 1.5 milion marka. Kjo ka ndodhur në shkurt të vitit 1999. Për këtë kontribut e falënderoj Zotin që na e ka dhënë këtë mundësi dhe gjithë ata të cilët kanë kontribuar në aspektin financiar për ta ndihmuar UÇK-në në ato ditë të vështira. Unë e kisha fatin ta udhëheq një shoqatë humanitare në kuadër të Caritasit gjerman në ato vite.

"Epoka e re": Keni llogaritur ndonjëherë se sa ka qenë vlera financiare e ndihmës që keni dhënë?

Fejzaj: Në bazë të faturave dhe llogaritjeve tona, shuma e ndihmave që kemi ofruar si shoqatë me ndihmën e donatorëve ka qenë rreth 16 milionë marka gjermane.

UNIVERSITETI TË PRISHTINËS
UNIONI I PAVARUR I STUDENTËVE
Tel&Fax: ++381 38 35 109
e-mail: upsp@albanian.com

SHOQATËS ATDHETARE "KOSOVA"
OLSBERG

LËNDA: Njohim për arrijtjen e pagesës.

Ju bëjmë me dije se nga shoqata e juaj kanë arritur 25.000 DM në fondin e Qeverisë së Kosovës të destinuar për Unionin e Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Këto mjete janë bartë nga fondi i qeverisë në fondin e Unionit të Pavarur të Studentëve.

Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës ju falënderon dhe ju shprehë mirënjohje për ndihmën e dhënë.

Ngrohtësisht ju përhëndesim.

UNIONI I PAVARUR I STUDENTËVE
TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

KRYETARI:
Bujar Dugolli

KËSHILLI QËNDOR PËR FINANCIM I KOSOVËS
Nr. Zc/98
Prishtinë, 30.10.1998

SHOQATA ATDHETARE "KOSOVA" OSBERG
z. Avdi Fejza
Gjermani

Informojmë se mjete e lejuara për Shoqatën e të Burgosurve Politikë shuma prej 82.750 DM, (tetëdhjet e dhjetë e shtatëqind e pesëdhjetë DM), ja dëhën në konton e Shoqatës e të Burgosurve Politikë në "DARDANIA BANK".

Këto mjete do t'ia japim Shoqatës sipas nevojës së tyre në momentin parë.

KOQK
/Ismail KASTRAI

KOPIE

10. Mjete Financiare për Këshillin Republikan për Ndihma Emergjente të Kosovës, dt. 03.07.1998. Shuma prej 98.200,00 DM. Dëshmia ka arritur më dt.08.02.1999. Nr.28/98.

11. Mjete Financiare për Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës:

1.05.02.1998.	shuma prej 28.000,00 DM
2.26.02.1998.	shuma prej 69.200,00 DM
3.14.04.1998.	shuma prej 69.000,00 DM
4.10.06.1998.	shuma prej 30.800,00 DM
3.20.08.1998.	shuma prej 85.150,00 DM
6.30.10.1998.	shuma prej 82.750,00 DM
7.04.01.1999.	shuma prej 86.000,00 DM
Totali i përgjithshëm:	420.930,00 DM

12. Mjete Financiare shtesë për Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës. Vendimi i dt.05.1998. në Kuvendin e Shoqatës Atdhetare Kosova në Olsberg. Volksbank-Brilon eg-daueruberweisung-fur jedes monat-betrag:48.150,00 DM. achtunwürtzikttausend und hundertfünfzig mark in Fondes der Republik von Kosovo Nr.2380100200-bankleitzahl:3020450-konto-nr.:des-Entlangers-betrag:13.05.1998. Dëshmia e Këshillit Qëndror për financim të Kosovës ka arritur Nr.55-dt.20.05.1998. Prishtinë, në këtë dëshmi thuhet se shuma prej 48.150,00 DM janë të "Dardania Bank" Tiranë. Kështu që këto Mjete Financiare Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës nuk i marrë këto mjete janë mbetur në Fondin e Republikës së Kosovës.

13. Mjete Financiare për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës-Shoqata Atdhetare Kosova në Kuvendin e saj të mbajtur më dt.20.09.1998, morri që të filloj aksionin për grumbullimin e mjeteve Financiare. Ky aksion zgjati 6 muaj që të filloj aksionin për grumbullimin e mjeteve Financiare. Ky aksion mori 1.500.000,00 DM, këto mjete janë destinuar për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës: Fondes der Republik von Kosovo; Ktr.2380100200-Bankleitzahl:1-63020450-von-datum:25.02.1999-Eberweisung r Volksbank Brilon eG-59929.

Kryetari i Shoqatës
Avdi Fejza

Bizneset e Kosovës vendosin kontakte me biznese amerikane

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Nën organizimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, një delegacion i bizneseve të Kosovës po qëndron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në fushën ekonomike.

Delegacioni ka zhvilluar takime me institucione të rëndësishme të cilat kanë selinë e tyre në Uashington DC, si në senatin amerikan, Odën Ekonomike të Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, Departamentin e Tregtisë, me përfaqësues të Administratës së Tregtisë Ndërkombëtare, Agjencisë "Select USA" dhe Korporatën e Investimeve Private Tejoqeanike (OPIC).

Gjatë këtyre takimeve delegacioni i bizneseve të Kosovës ka prezantuar zhvillimet pozitive në aspektin e të bërit biznes si dhe është interesuar për gjetjen e partnerëve amerikanë për realizimin e projekteve të për-

bashkëta investive në Kosovë, për të cilat do të mund të siguroheshin financime nga organizata si OPIC, të cilët u shprehën të interesuar për financim të projekteve të mundshme.

Delegacioni pati takime edhe me ambasadorin e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlorë Çitaku, ku u diskutua për fuqizimin e diplomacisë ekonomike me qëllim të një promovimi më të mirë të produkteve nga Kosova në shtetet ku

operojnë përfaqësitë diplomatike të Kosovës, por edhe nxitjen e bashkëpunimit më të madh ekonomik me bizneset e shteteve nikoqire. Delegacioni u prit edhe nga Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Uashington, Floreta Luli-Fabwr. Përfaqësuesit e bizneseve kosovare nga sektorë të ndryshëm si prodhim, tregti, shërbime konsulente, teknologji e informacionit dhe shërbime të kujdesit mjekësor qëndruan edhe në

Richmond të shtetit të Virxhinias, ku u pritën nga kompania amerikane "Williams Mullen", ndërsa zhvilluan takime edhe me përfaqësues të Shoqatës së Bizneseve Greater Richmond Partnership si dhe Lead Virginia.

Gjatë vizitës në Universitetin James Madison përfaqësuesit e bizneseve nga Kosova patën mundësi të mësojnë më tepër për programet e ndërmarrësisë që zhvillohen në këtë universitet.



BQK-ja: Mbi 300 000 qytetarë shfrytëzojnë shërbimin e-banking

PRISHTINË, 25 TETOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se llogaritë bankare e-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar të rriten. "Në dhjetor 2017 numri i gjithsejtë llogarive e-banking ishte 301.8 mijë, duke shënuar rritje vjetore prej 30.7 përqindësh. Po ashtu, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit e-banking është rritur. Numri i gjithsejtë transaksioneve të realizuara përmes llogarive e-banking gjatë vitit 2017 arriti në 3.4 milionë, një rritje vjetore prej 16.9 përqindësh, ndërsa vlera e gjithsejtë transaksioneve të realizuara përmes llogarive e-banking arriti në 8.5 miliardë

euro, që paraqet një rritje vjetore prej 26.6 përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, struktura e llogarive e-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 98.2 përqindësh. "Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 82.5 përqind të gjithsejtë llogarive përderisa pjesa e mbetur prej 17.5 përqindësh nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jorezidentëve dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 91.8 përqindësh, përderisa llogaritë afariste kanë një pjesëmarrje prej 8.2 përqindësh", është theksuar më tutje në raportin e BQK-së.



Kërkohet vëmendje institucionale për projektligjet ekonomike

Njohësit e çështjeve ekonomike, Hekuran Murati dhe Ismet Mulaj, kanë kërkuar që deputetët të jenë më të përgjegjshëm sa iu përket përgjegjësve që i kanë konform ligjeve ekonomike. Sipas tyre, çdo prolongim i projektligjeve ekonomike është sinjal negativ për investitorët e huaj

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 TETOR - Në Kuvendin e Kosovës kanë kaluar në parim Projektligji për të Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe ai për Tatimin në të Ardhurat Personale. Këto dy projektligje u bartën nga seanca e kaluar pasi nuk kanë mundur të hidhen në votim për shkak të mungesës së kuorumit. Në lidhje me këtë çështje, eksperti financiar Hekuran Murati ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sa iu përket projektligjeve janë dy ndryshime për të cilat do të duhej të bëhej debat, heqja e tatimit prej pesë përqindësh në primet e shkruara nga kompanitë e sigurimeve, si dhe heqja e dividendës nga të hyrat e lirura nga tatimi.

Murati ka thënë se mungesa e kuorumit në seancat plenare, edhe pse tërthorazi ndikon në efektet makroekonomike, është sinjal negativ që çon tek investitorët potencialë të huaj. "Mungesa e kuorumit në Kuvend nuk është se ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit për arsye se projektligjet në fjalë nuk parashohin ndryshime substanciale në politikat fiskale. Mirëpo ndikimi vjen tërtho-

razi për aq sa kjo gjendje e ngecjes së legjislativit të vazhdojë, për shkak se të investitorët e mundshëm çon sinjale të mungesës së stabilitetit politik dhe pasigurisë në investime", ka thënë Murati, duke shtuar se heqja e tatimit prej pesë përqindësh në primet e shkruara nga kompanitë e sigurimeve nëse zbatohet si duhet, paraqet një hap para në zhvillimin e sektorit të sigurimeve jo të detyrueshme. "Megjithatë, duhet shtuar kujdesi dhe mbikëqyrja nga ana e BQK-së dhe ATK-së në mënyrë që të evitohen manipulime të cilat çojnë në nëndeklarim të fitimit të kompanive të sigurimeve", ka thënë ai.

Kurse sa i përket rikthimit të dividendës në kategorinë e të hyrave që tatimoren, paraqet hap prapa sa i përket tërheqjes së investimeve të reja. "Për shkak se me këtë veprim zvogëlohet niveli i kthimit në investim dhe me të edhe interesimi për të investuar", është shprehur Murati. Njohësi i çështjeve ekonomike dhe ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ismet Mulaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se momentum i krijuar në Kuvendin e Kosovës është duke pamundësuar krijimin e reformave ekonomike.



"Situata e cila është krijuar në Kuvendin e Kosovës po pamundëson krijimin e reformave ekonomike, pasi po pamundësohet miratimi i ligjeve të cilat janë strukturore për mënyrën e të bërit biznes në Kosovë", ka thënë Mulaj. Ai ka shtuar se ky neglizhim i deputetëve të Kosovës dhe mospjesëmarrja në seancë, kur në rend dite janë ligjet ekonomike, është stimulim për investitorët e huaj. "Situata e krijuar fatkeqësisht është

duke e zvogëluar mundësinë që në vendin tonë të vijnë dhe të investojnë investitorët e huaj, duke marrë parasysh edhe faktin që vendet që kanë korrupsion dhe probleme politike nuk janë atraktive për investitorët e huaj. Prandaj, kjo situatë nuk është e favorshme për reformat strukturore ekonomike", ka thënë Mulaj. Ndërkaq sa i përket tatimit të dividendës, Mulaj ka thënë se çdo tatim i ri dhe çdo taksë e re është barrierë për t'i bindur

investitorët e huaj për të investuar në Kosovë. "Do të apeloja te të gjithë deputetët e Kosovës që mos ta ngarkojnë sistemin tatimor me taksë të reja. Pastaj kemi edhe taksën prej pesëpërqindësh të të tatuarit në qarkullim për kompanitë e sigurimeve në Kosovë. Kjo është ngarkesë dhe në këtë mënyrë po krijon një situatë jo të favorshme për ta zhvilluar afatizimin e tyre në Kosovë", është shprehur Mulaj.

Veseli me delegacionin e FMN-së: Kosova ka një borxh publik shumë të ulët



PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të enjten një delegacion nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, me të cilin ka diskutuar për stabilitetin makro-fiskal të Kosovës dhe për buxhetin e vitit 2019. "Ky buxhet është real, i balancuar dhe i fokusuar kryesisht në investime kapitale dhe në zhvillim të vendit. Kosova vazhdon të jetë i vetmi vend në Ballkan që ka një borxh publik shumë të ulët, me një rritje ekonomike stabile dhe me një planifikim buxhetor i cili siguron stabilitet për institucionet publike dhe stimulon sektorin privat", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se viti i ardhshëm do të jetë vit i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, i shumë projekteve të mëdha në të mirë të qytetarëve dhe i hapjes së vendeve të reja të punës në sektorin privat.

Begaj me përfaqësuesit e AKP-së diskutuan për asetet me rëndësi për Komunën e Malishevës

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Kryesuesi i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Petrit Gashi, bashkë me drejtorin menaxhues të kësaj agjencie, Ekrem Hajdari,



kanë pritur të enjten në takim kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si dhe drejtorin e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, Bashkim Krasniqi. Në këtë takim u diskutua lidhur me

asetet e ndërmarrjeve shoqërore, në veçanti për ato me rëndësi vitale për Komunën e Malishevës si dhe për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për identifikimin e aseteve të tilla.

Në Suharekë mbahet takimi i radhës për hartimin e planit zhvillimor komunal

SUHAREKË, 25 TETOR (ER) - Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim e Suharekës, së bashku me ekipin komunal për planifikim dhe kompaninë konsulente INSI nga Prishtina, kanë mbajtur të enjten takimin e radhës, në të cilin është diskutuar draftdokumenti i Planit Zhvillimor Komunal i cili së shpejti pritet të dalë në diskutim publik. Nga të pranishmit u diskutua faza në të cilën ndodhet drafti dhe hapat e mëtu-



jeshëm që duhen marrë. Nga drejtoritë u kërkua që sa më parë të dorëzohen raportet sektoriale me vërejtjet dhe sugjerimet rreth draftit i cili, pas kompletimit, do të procedohet sipas legjislacionit në fuqi.



Përkujtohen dëshmorët e kombit, Naim Beka dhe Agim Matoshi

FERIZAJ, 25 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi, drejtorë komunalë, përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëlufetarë dhe qindra qytetarë kanë bërë të enjten homazhe te varrezat e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Ferizaj, në nderim të jetës dhe veprës së dëshmorëve të kom-

bit, Naim Beka - Sokoli dhe Agim Matoshi.

I pari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se dy trimat e Ferizajt, Naim Beka dhe Agim Matoshi, janë shembulli më i mirë ku trimëria, zgjuarsia dhe atdhedashuria farkojnë lirinë e popullit tonë.

Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi, ka thënë se këta dy dëshmorë ishin ushtarë dhe trima të pashembullit të historisë më të

re të kombit shqiptar. Ndërsa Rafiz Sejdiu, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Ferizaj, ka theksuar se dy dëshmorët e kombit, Naim Beka dhe Agim Matoshi, që po përkujtojnë sot në përvjetorin e rënies heroike, ishin ndër ushtarët e parë të UÇK-së dhe themeluesit e Batalionit të Logjistikës, të shquar për trimërinë dhe zgjuarsinë e tyre.



Gjilani nis ndërtimin e 'Rrugës së Kumanovës'

GJILAN, 25 TETOR (ER) - Komuna e Gjilanit ka nisur ndërtimin e pjesës së parë të "Rrugës së Kumanovës" në gjatësi prej 870 metrave. Gjatë vizitës së punimeve, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ndihet mirë që ndërtimi i kësaj rruge po bëhet nga granti i performancës që komuna e ka fituar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe DEMOS

si rezultat i performancës së lartë për vitin 2017. "Jam shumë i lumtur që filluam pjesën e parë të kësaj rruge, e cila është një arterie shumë e rëndësishme e qarkullimit të qytetarëve dhe e shkarkon jashtëzakonisht shumë pjesën e qytetit nga komunikacioni. Po e ndërtojmë fillimisht infrastrukturën nëntokësore, për të vazhduar atë mbitokësore, tro-

tuaret e ndriçimin", ka thënë Haziri.

I pari i Gjilanit ka njoftuar se rruga ka gjerësi prej 11 metrash dhe do të punohet sipas standardeve më të larta. Ndërtimi i pjesës së parë të "Rrugës së Kumanovës" kap koston e 305 mijë eurove, ku 205 mijë euro janë nga granti i performancës, ndërkaq Komuna participon me 100 mijë euro.

Rregullohet dhe pastrohet shtrati i Lumëbardhit

PRIZREN, 25 TETOR (ER) - Në kuadër të projekteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Prizrenit është edhe rregullimi i shtratis të lumit prej "40 Bunarit" e deri në qytet. Projekti parasheh largimin e mbeturinave, zgjerimin e

shtratit në vende ku është i ngushtuar dhe nivelizimin e tij. Gjatësia e Lumëbardhit në këtë segment është pesë kilometra, ndërsa hapja e rrjedhës është i rëndësishëm, posaçërisht për shkak të evitimit të përmbytjeve në të ardhmen.



Putini paralajmëron një garë të re armatimi

MOSKË, 25 TETOR - Presidenti rus Vladimir Putin paralajmëroi një garë të re armatimesh, nëse presidenti Donald Trump i përmbahet kërcënimit për t'u tërhequr nga një prej marrëveshjeve kryesore për kontrollin e armëve. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, konfirmoi se Rusia e ka shkelur traktatin

dhe, megjithatë, hodhi poshtë mundësinë e një riarmatimi bërthamor në Evropë. Pas bisedimeve me kryeministrin italian Giuseppe Conte, Putini tha se Rusia është përgatitur për t'iu përgjigjur vendosjes nga Shtetet e Bashkuara të raketave me rreze të mesme në Evropë. "A do të përgjigjemi

dot? Po, do të përgjigjemi me shpejtësi dhe efektshmëri. Cili mund të ishte preteksti formal i partnerëve tanë për të dalë nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme? Akuzat se ne e kemi shkelur atë. Por, si zakonisht, nuk paraqitet asnjë provë. Dhe ShBA-ja e ka shkelur traktatin tashmë", deklaroi Putini.



NATO-ja nis stërvitjet ushtarake, Rusia në mendjen e secilit

Më shumë se 50 000 ushtarë, 10 000 automjete, 65 anije dhe 250 aeroplanë nga 31 shtete do të jenë pjesë e stërvitjeve ushtarake të titulluara "Trident Juncture", të cilat kanë për qëllim trajnimin e Aleancës për t'i mbrojtur vendet anëtare nga agresioni

OSLO, 25 TETOR - Norvegjia do të jetë nikoqire e stërvitjeve më të mëdha të nisura të enjten nga NATO-ja prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, duke i rikujtuar Rusisë që aleanca mbetet e bashkuar pavarësisht prej dyshimeve që ka shpërfaqur në këtë aspekt presidenti amerikan Donald Trump.

Më shumë se 50 000 ushtarë, 10 000 automjete, 65 anije dhe 250 aeroplanë nga 31 shtete do të jenë pjesë e stërvitjeve ushtarake të titulluara "Trident Juncture", të cilat

kanë për qëllim trajnimin e Aleancës për t'i mbrojtur vendet anëtare nga agresioni. "Në vitet e fundit ambienti i sigurisë në Evropë është përkeqësuar ndjeshëm", ka thënë sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në Norvegji. "Trident Juncture dërgon mesazh të qartë për kombet tona dhe për ndonjë armik potencial. NATO-ja nuk kërkon përballje, mirëpo ne jemi të gatshëm për t'i mbrojtur të gjithë aleatët tanë kundër çdo kërcënimi", ka thënë ai para gaze-

tarëve të mërkurën.

Ndonëse "armiku potencial" nuk është identifikuar zyrtarisht, Rusia ka qenë në mendjen e secilit. Ky shtet, që ndan një kufi prej 198 kilometrave me Norvegjinë në Veri, ka përmendur vazhdimisht në vitet e fundit fuqinë e saj ushtarake.

Ushtria ruse ka aneksuar Krimenë, ka ndihmuar në destabilizimin e lindjes së Ukrainës, ka rritur kapacitetet ushtarake në Arktik dhe ka kryer stërvitjet ushtarake më të mëdha të realizuara ndonjëherë në muajin shtator.

Stërvitje "antiruse"

Ambasada ruse në Oslo i ka konsideruar stërvitjet e NATO-s "antiruse". "Një aktivitet i tillë

është provokativ edhe nëse tentoni ta arsyetoni kinse është duke u realizuar për qëllim të pastra të mbrojtjes", është thënë në deklaratën e kësaj ambasade. Përveç të tjerash, Moska ka qenë e zemëruar për muaj të tërë për rritjen e pranisë ushtarake të Perëndimit në rajon. ShBA-ja dhe Britania kanë rritur numrin e trupave të tyre në Norvegji për t'i ambientuar me luftime në mot të ftohtë.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova, pati dënuar në muajin janar hapat e NATO-s, duke premtuar se Moska do të marrë "masa hakmarrëse". "Shtetet kryesore të NATO-s janë duke rritur praninë e tyre ushtarake në rajon, afër kufirit me Rusinë", ka thënë ajo. "Hapa të

tillë të papërgjegjshëm ndikojnë në destabilizim të situatës politike në veri dhe rrisin tensionet", pati thënë ajo.

Mirëpo tensionet veç janë ritur nga dita e shtunë, pasi presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar për tërheqjen e ShBA-së nga Traktati për Armët Bërthamore, që ka nënshkruar me Rusinë më 1987. Pas këtyre deklaratave, Rusia ka thënë se një vendim i tillë amerikan mund të nxisë "garë të re armësh". Mirëpo duke akuzuar Rusinë për shkelje të këtij Pakti, Trumpi ka kërcënuar me rritje të arsenalit të armëve bërthamore amerikane.

A është i sigurt Artikulli 5?

Pavarësisht prej shqetësimeve lidhur me përkushtimin e Trumpit në Aleancën veri-atlantike, përkatësisht "Artikullit 5" që përcakton mbrojtje të përbashkët, Ushtria amerikane është kontribuuesja më e madhe në stërvitjet e së enjtes, pasi më shumë se 14 000 trupa të saj do të jenë pjesë e organizimit. "Ne do të kryejmë stërvitje në Norvegji, mirëpo natyrisht se mësimet nga to janë të rëndësishme edhe për shtetet e tjera", është shprehur Stoltenbergu. Katër ushtarë amerikanë janë lënduar lehtë të martën teksa kanë bartur materialin e nevojshëm për stërvitje. Përveç 29 shteteve të NATO-s, pjesë e këtyre stërvitjeve do të jenë edhe fqinjët e Norvegjisë, Suedia dhe Finlanda. Për t'i monitoruar manovrimet e NATO-s, të cilat zgjasin deri më 7 nëntor, janë ftuar edhe dy zyrtarë ushtarakë nga Rusia dhe Bjellorusia. Stoltenbergu ka thënë se shpreson që Rusia "ta shmangë qasjen e rrezikshme".



Niko Bratov (EPA-EFE)

Boltoni: Do ta shtrydhim Iranin

JEREVAN, 25 TETOR - Këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, Michael Bolton, është zotuar se administrata e presidentit amerikan Donald Trump do ta shtrydhë Iranin me presion të madh ekonomik, për shkak të, siç ka thënë, të sjelljes "keqdashëse" të tij në Lindjen e Mesme dhe në gjithë botën. Boltoni këto komente i ka bërë në një intervistë ekskluzive për

"Radion Evropa e Lirë", pas takimit me kryeministrin armen Nikol Pashinian, në Jerevan. "Siç i thashë edhe kryeministrit, duam të bëjmë presion maksimal mbi Iranin, sepse ai nuk ka hequr dorë nga synimi për krijimin e armëve bërthamore", tha ai. "Irani mbetet bankieri kryesor në botë i terrorizmit ndërkombëtar. Dhe, ne jemi të shqetësuar për programin e tij

me raketa balistike dhe për operacionet e tij ushtarake në Siri, Irak dhe gjetkë", ka thënë Boltoni. "Do ta shtrydhim Iranin, sepse mendojmë se sjellja e tij në Lindjen e Mesme dhe, në fakt, globalisht është keqdashëse dhe duhet të ndryshojë", ka thënë zyrtari i lartë amerikan.

Në muajin maj Trumpi e ka tërhequr ShBA-në nga mar-



rëveshja bërthamore me Iranin dhe ka rikthyer sanksionet ekonomike kundër tij. Irani

vazhdimisht ka thënë se programi i tij bërthamor ka vetëm qëllime paqësore.

E jashtëzakonshme

Futbollisti nga Kenia mbjell pemë sa herë që shënon gol

Një futbollist i ri nga Kenia e feston golin në mënyrën më të veçantë dhe në shërbim të natyrës. Adoleshenti Lesein Yes mbjell një pemë sa herë që shënon gol. Ai ka rrëfyer se e ka bërë këtë gjë pasi ka mësuar dhe dëgjuar për shpyllëzimin. Djali 14-vjeçar shpreson se kjo



inicativë e tij të shtrihet në të gjithë kontinentin afrikan.

FOTO E DITES



Një kështjellë e vjetër shihet mbi pemët shumëngjyrëshe në fshatin Bacharach të Gjermanisë. /AP/

E rrallë

Artisti që mbulon vrimat me mozaikë

Ai vishet si punëtor dhe shkon për t'i mbuluar vrimat në rrugët e Manhatanit dhe Brooklyn, në Nju Jork, me mozaikë të mrekullueshëm. Ky është Jim Bachor, artisti 54-vjeçar tashmë i njohur për sjelljen e artit të njëjtë në rrugët e Çikagos, në shtetin e Illinois. "Vrimat janë të



vërteta dhe universale", ka thënë ai për "The Post".



DASHI

Po vini në pikëpyetje të gjithë gjërat që një person i afërt ka bërë për ju. Shumë shpejt do ta kuptoni që keni gabuar në disa raste.



DEMI

Në të ardhmen nuk keni pse fshiheni pas premtimeve boshe që ju kanë bërë. Është mirë të filloni ta krijoni pavarësinë tuaj dhe t'i ridimensiononi marrëdhëniet.



BINJAKËT

Megjithëse jeni përpjekur me mish e me shpirt të përfundoni një projekt të caktuar, kushtet dhe rrethanat nuk jua kanë lejuar këtë gjë.



GAFORRJA

Lejojini një personi t'ju japë zgjidhjet e veta sot. Me pak mbështetje mund të bëhet aleati më i mirë i juaj në të ardhmen.



LUANI

Aktivitetet që keni për sot mos i shtyni për një afat të pacaktuar. Shumë gjëra do të jenë në varësi të situatave të krijuara ditën e sotme.



VIRGJËRESHA

Nuk keni një gjykim të drejtë mbi situata dhe persona të caktuar. Prisni të jeni të sigurt përpara se ta shprehni opinionin tuaj.



PESHORJA

Do të ndikoheni nga persona që do t'ju ndryshojnë totalisht këndvështrimin e gjërave. Jeni bërë fleksibël kohët e fundit.



AKREPI

Sot duhet ta lini mënjane krenarinë tuaj dhe të bëni ç'është e mundur për të finalizuar një projekt të përbashkët. Do të shpërbleheni për mundin.



SHIGJETARI

Çdo gjë që keni zgjedhur të bëni sot do të përkojë me planet tuaja për ditën. Jeni më të qetë kur bëni një planifikim paraprak.



BRICJAPI

Shumë njerëz mësojnë nga gabimet e tyre dhe e njëjta gjë do t'ju ndodhë edhe juve. Përvoja ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie.



UJORI

Keni bërë zgjedhje të rëndësishme dhe sot nuk mund të ktheheni pas edhe nëse do të dëshironit. Pak më fleksibël në raport me partnerin sot.



PESHQIT

Personat pranë jush janë disi të bezdisur nga sjellja juaj kohët e fundit. Do të preferonin t'ju shihnin siç keni qenë gjithmonë.

BARSOLETA E DITËS



Gjykatësi: Si mund ta vrisnit gruan pas 20 vjetësh martesë?
I akuzuari: Kisha ndërmend ta vrisja moti, po si na shqiptarët që i lëmi punët hajt sot e hajt nesër, deri tash që i erdh kësmeti!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennessey, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr




Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	QPR - ASTON VILLA	1	VALLADOLID - ESPANYOL	1	DARMSTADT - GREUTHER FURTH	1
-------------------	-------------------	---	-----------------------	---	----------------------------	---



Flamurtari synon ta shlyejë serinë e zezë ndaj Ferizajt

Flamurtari i Prishtinës synon ta shlyejë serinë e zezë të rezultateve në IPKO Superligë. "Ferizaj ka një skuadër të mirë, por ne pas dy humbjeve synojmë të mos rikthehemi duarbosh nga kjo ndeshje. Për këtë ndeshje kemi dy mungesa të mëdha, Alban Shillovën dhe portierin Flamur Nezirin, por prapëseprapë synojmë rezultat pozitiv", ka thënë Veton Kabashi për "Epokën e re"

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 25 TETOR - KF Flamurtari, që ishte skuadra që befasoi në pesë xhirot e para, duke e kryesuar edhe renditjen në elitë, në ndeshjet e fundit është duke u përballur me një krizë rezultatesh. Në fakt, Flamurtari që shtatë ndeshje është pa fitore, kurse në dy ndeshjet e fundit ka pësuar humbje. Kapiteni i Flamurtarit, Veton Kabashi, ka thënë të enjten për gazetë se kuqezinjtë në Ferizaj e synojnë të paktën një barazim. "Ferizaj ka një skuadër të mirë, por ne pas dy humbjeve synojmë të mos rikthehemi duarbosh nga kjo ndeshje. Për këtë ndeshje kemi dy mungesa të mëdha, Alban Shillovën dhe portierin Flamur Nezirin, por

prapëseprapë synojmë rezultat pozitiv", ka thënë Kabashi. Për ndeshjen që zhvillohet sot foli edhe sulmuesi Dren Gashi. "Si në çdo ndeshje tjetër, edhe sfida kundër Flamurtarit është e rëndësishme për ne. Në këtë ndeshje mungojmë unë dhe Kristi Marku për shkak të kartonëve, por Ferizaj ka fond të mjaftueshëm për të dalë fitues në këtë ndeshje. Kundërshtari ka një ekip cilësor dhe shumë të papërshtatshëm, por ekipi ynë do ta japë maksimumin për t'i marrë pikët e plota", ka deklaruar Gashi. Krahas ndeshjes Ferizaj - Flamurtari, sot (e premte) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Në Suharekë Ballkani e pret Lirinë, kurse KEK-u luan ndaj kampionëve të Dritës. Tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen nesër (e shtunë),

ku që të tria vlerësohen si derbi: Trepça '89 - Feronikeli, Gjilani - Prishtina dhe Drenica - Llapi.

IPKO SUPERLIGA

Të premten takohen:
Ferizaj - Flamurtari
Ballkani - Liria
KEK-u - Drita

Të shtunën takohen:
Trepça '89 - Feronikeli
Gjilani - Prishtina
Drenica - Llapi
(Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 13:45)

SHKURT

Kosova ngrehet në renditjen e FIFA-s, bien Shqipëria dhe Gjermania

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, pas fitores ndaj Maltës dhe barazimit me Ishujt Faroe, është ngritur për një pozitë në renditjen e FIFA-s për muajin shtator. "Dardanët" e drejtuar nga Bernard Challandes tash janë në vendin e 137 në renditjen e FIFA-s. Kombëtarja e Shqipërisë, pas humbjes me Izraelin, ka humbur tre pozicione dhe tani renditet në vendin e 60. Krua e renditjes ka mbetur i njëjtë, teksa Belgjika është e para e ndjekur nga Franca. Brazili mbyll podiumin, ndërkohë që Anglia është ngjitur në vendin e pestë, një pozicion pas Kroacisë. Gjermania ka pësuar sërish rënie, teksa tanimë ka zbritur dy vende dhe pozicionohet e 14-ta.

Kloppi: Shaqiri ishte i përfshirë në gjithçka

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka veçuar performancën e Xherdan Shaqirit, krahas asaj të Adam Lallanas e Fabinhos në fitoren ndaj Crvena Zvezdës në Ligën e Kampionëve (4-0). "Ishte mirë që shënuan treshja e sulmit, por ishte mirë që pamë edhe Adamin që u kthye, pamë kundërsulme, pasime si dhe lojën e Danielit. Ishte një ndeshje e mirë futbollit dhe një fitore e merituar. Fabinho ishte i mirë nga fillimi - Shaqiri u përfshi në gjithçka. Është një lojtar shumë i mirë dhe kjo na ndihmoi. Mendoj se ai pati paraqitje shumë të mirë", ka thënë Klopp.

Majlinda u rikthehet garave

Majlinda Kelmendin do ta shohim në gara këtë fundjavë, pas 14 muajsh pauzë, shkaku i lëndimit të pësuar në Kampionatin Botëror Budapest 2017, të mbajtur në fund të muajit gusht të vitit të kaluar. Kampionia Olimpikë nga Lojërat Olimpikë Rio 2016 do të garojë në Grand Slamin e xhudos Abu Dhabi, të Emirateve të Bashkuara Arabe, që mbahet prej 27-29 tetor. Në Abu Dhabi, Majlinda kishte fituar medaljen e artë në vitet 2011, 2012 dhe 2014, ndërsa në 2015-n fitoi të bronzën. Trajneri i Majlindës, Driton Kuka, është i lumtur që Kelmendi po kthehet në gara. "Po, Majlinda do të kthehet këtë javë në gara, pas një pauze të gjatë. Sa i përket medaljes është pauzë e gjatë dhe nuk e di se si ka ndikuar", ka thënë Kuka për "noc-kosovo.org". Krahas Majlindës, që garon në kategorinë -52 kilogramë në Abu Dhabi, që vlen për pikë Olimpikë Tokyo 2020, vendin tonë e përfaqësojnë edhe kampionia e Evropës në kategorinë deri 57 kilogramë, Nora Gjakova, Distria Krasniqi (-48 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg). Majlinda, Nora dhe Distria do të garojnë të shtunën, ndërsa Akili të dielën.

Altin Zogaj në nëntor përballlet me hungarezin Zeller

PRISHTINË, 25 TETOR - Boksieri shqiptar nga Drenica, Altin Zogaj, që jeton në Gjermani, më 3 nëntor në Wangen të Gjermanisë do të përballlet në boksion profesionist me hungarezin Istvan Zeller, i cili ka

një përvojë ta madhe në boksion profesionist me 38 fitore. "Po përgatitem që njëmbëdhjetë javë. Fazën e parë e kam bërë në Stuttgart, kurse fazën e dytë në bjeshkët e Austrisë me Festim Kryeziun,

i cili do të boksoj në meçin kryesor në atë mbrëmje për kampion të Evropës. Fazën e tretë e kam bërë në Berlin, përkatësisht te 'Agon Sports', me ish-trajnerin e Luan Krasniqit, Torsten Schmitz",

ka thënë Zogaj për "Epokën e re". Për boksierin shqiptar kjo është lufta e tretë në boksion profesionist dhe me hungarezin përballlet në kategorinë gjysme të rëndë deri në 79.3 kg.



Feniksi tërhiqet nga të gjitha garat

Prishtinë, 25 tetor- Skuadra kampione e Kosovës në fut-sall, Feniksi, është tërhequr nga të gjitha garat. Në njoftimin e bërë publik bëhet me dije se mospërkrhja nga institucionet shtetërore ka qenë një prej arsyeve krye-

sore për të ndërmarrë një veprim të tillë. "FC Feniks ka vendosur ta ndërpresë pjesëmarrjen në garat kampionale dhe garave për kupë duke u tërhequr nga çdo aktivitet sportiv. Është vendim i dhimbshëm, por i menduar

gjatë dhe hollësisht që sjell deri te ky hap jo edhe i lehtë për ne, që ndër vite i kontribuam sportit me paraqitje dinjitoze dhe me vlera të sjelljes sportive, duke u renditur tashmë si skuadra më e suksesshme e futbollit koso-

var që nga themelimi i saj", thuhet në njoftimin e Feniksit. "Shpresojmë se institucionet shtetërore ta kuptojnë faktin se sporti nuk mbijeton pa ndihmën e tyre", thuhet në njoftimin e klubit nga Drenasi.



'Prishtina' me penallti e mposhti 'Bardhosh Gërvallën'

PRISHTINË, 25 TETOR - Në organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës sot në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet u zhvillua ndeshja e Superkupës Kosovë - Diasporë ndërmjet fituesit të Digitalb Kupës së Kosovës FC "Prishtina" dhe fituesit të Kupës së Kosovës për Diasporë AVK "Bardhosh Gërvalla" nga Ludwisburgu i Gjermanisë. Në pjesën e parë ishte një ndeshje e baraspeshuar dhe ndonëse skuadra nga Gjermania me futbollistë amatorë arriti shumë mirë ta përballojë skuadrën nga kryeqyteti, e cila në fushë u paraqiti me futbollistët e përbërjes së dytë. Kështu që pjesa e parë u mbyll pa gola. Pjesa e dytë nuk solli aspak ndryshime në lojë



dhe rezultat, kështu që ndeshja shkoi në penallti, ku më të saktë u treguan futbollistët e Prishtinës, të cilët e fituan ndeshjen 4-2. Në fund kupën ekipit fitues ia dorëzoi anë-

tari KE Mirsad Çollaku, ndërsa ekipit të AKV "Bardhosh Gërvalla" kupën për pozitën e dytë ia dorëzoi zëvendëssekretari i FFK-së, Arianit Ahmeti.

Curry shënon 51 pikë, fiton Golden State

OAKLAND, 25 TETOR - Skuadra kampione e Golden States ka mposhtur 144-122 Washington në ndeshjen e radhës së kampionatit të NBA-së, një sfidë me "5 yje" për Stephen Curry, që realizoi 51 pikë për Warriorsin. Një ndeshje e dominuar nga vendësit, që diktuan gjatë gjithë kohës në fushë, duke korrur fitoren e 4-t sezonale edhe falë 30 pikëve të Durantit. Fitoren e parë në kampionat arriti ekipi i Lakersit, që mundi 131-113 Phoenixit jashtë fushës. Një takim i komanduar nga miqtë, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (Stephenson më i miri me 24 pikë), ndërkohë që LeBron e mbylli me 19 pikë e 10 asistime. Toronto mbetet skuadra më e mirë aktualisht në NBA, me 5 fitore e asnjë humbje deri më tani, duke mposhtur sot 112-105



Minnesota, ndeshje e dominuar nga kanadezët. Leonardo me 35 pikë ishte lider në fushë për Toronton. Vijn të zhgënjë skuadra e Clevelandit që, pas largimit të LeBronit, nuk po gjen dot rrugën drejt fitores. Cavaliersi u mund 102-86 nga Brooklyn, me Russellin që ishte shënuesi më i mirë me 18 pikë. Zhgënjën sërish skuadra e

REZULTATET

Atlanta - Dallas	111-104
Cleveland - Brooklyn	86-102
Miami - New York	110-87
Toronto - Minnesota	112-105
Chicago - Charlotte	112-110
Houston - Utah Jazz	89-100
San Antonio - Indiana	96-116
Milwaukee - Philadelphia	123-108
Phoenix - Lakers	113-131
Sacramento - Memphis	97-92
Golden State - Washington	144-122

Houstonit, që u mund 100-89 nga Utah Jazz, duke pësuar disfatën e tretë (ka vetëm një fitore). Edhe pse Hardeni realizoi 29 pikë e Anthony 22, ato s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Jazzin u dallua Mitchell me 38 pikë.

Sot zhvillohen ndeshjen e xhiros së shtatë në Media Ligë

PRISHTINË, 25 TETOR - Sot (e premte) zhvillohen ndeshjet e javës së shtatë në Media Ligë, kurse priten ndeshje interesante. Ekipi lider i kësaj lige, "Epoka e re", do të luajë ndaj ekipit të "RIV Dukagjini", derisa synimi i kryesuesve është fitorja edhe në këtë përballje mjaft të fortë. Dy ekipet përcjellëse të "Epokës së re", "Lajmi.net" dhe "Klan Kosova" kanë ndeshje të forta para vetës, pasi luajnë ndaj "Telegrafi"-it dhe "KosovaPress"-it. Në ndeshjet e tjera takohen: "Gazeta Blic" - "Media Works", "Kallxo.com" - "Gazeta Metro", "Ora Info" - "Infokusi", "InfoKosova & PrishtinaPost" - "Gazeta Zëri", "Lajmi.net" - "Telegrafi", "RTK" - "D+", "RIV Dukagjini" - "Epoka e re", "Klan Kosova" - "KosovaPress".



SHKURT

Simeone: Më mahniti Dortmundi

Disfata 4-0 nga Borussia Dortmundi ishte më e thellë për Diego Pablo Simeonen në 360 ndeshje në krye të stolit të Atletico Madridit. "Më mahniti Borussia Dortmundi. Luajti në mënyrë praktike, dinamike, shumë të shpejtë, vertikalizoi dhe evitoi mbajtjen e tepruar të topit. Nuk më mbetet veçse t'i përgëzoj: janë në një rrugë shumë të mirë dhe tashmë duhet ta ruajnë këtë mënyrë loje, sepse është mjaft e bukur t'i shohësh", ka thënë Simeone.

Ozili: Ende e përkrahi Gjermaninë

Futbollisti i Arsenalit, Mesut Ozil, që është larguar nga Kombëtarja e Gjermanisë, pas Kupës së Botës "Rusi 2018", ka thënë se ende e përkrah këtë kombëtare. "E kam përkrahur Gjermaninë që nga fëmijëria dhe ende kam miq që luajnë për Kombëtaren. Pa dyshim se ende e përkrah Gjermaninë", ka thënë Ozili.

UFC pezullon Khabib Nurmagedov dhe Conor McGregor


Komisioni Sportiv në Nevada vendosi pezullimin për një afat të pacaktuar të Khabib Nurmagedov dhe Conor McGregor për përlëshjen që ndodhi pas ndeshjes së 6 tetorit në Las Vegas. Madje kampioni i UFC-së, Khabib do të marrë vetëm një milion dollarë nga dy sa ishte parashikuar të merrte për ndeshjen e zhvilluar me irlandezin. Khabibi doli nga ringu për t'u përlëshur me stafin e McGregorit pas ndeshjes, të cilin e fitoi me ndërprerje në raundin e katërt. Komisioni i Nevadas ka votuar që t'i jepjen Nurmagedovit një milion dollarë, ndërsa një milion tjetër do t'i pezullohet deri në përfundim të dëgjimit të seancës disiplinore në dhjetor. Si McGregor ashtu edhe Nurmagedov kanë kërkuar të marrin pjesë në seancën dëgjimore.

Leicesteri interesohet për ish-trajnerin e Monacos


Pushimet e Leonardo Jardim mund të zgjasin shumë pak. Tekniku ka vetëm pak javë që është shkarkuar nga klubi i Monacos por, sipas medieve franceze, ai mund ta marrë drejtimin e një tjetër skuadre. Anglezët e Leicester Cityt janë të parët të cilët po interesohen për teknikun portugez. Pozicioni i Claude Puel në krye të "Dhelveprave" ka filluar të lëkundet, pas një nisjeje jo të mirë të sezonit nga ana e tyre, ku në 9 takime kanë arritur të marrin vetëm 12 pikë. Për këtë arsye, drejtuesit e klubit anglez kanë nisur të mendojnë për një tjetër alternativë për stolin dhe Jardim për momentin duket se është i zgjedhuri.

Lippi: Juve favorit në të gjitha kompeticionet

Trajneri i njohur italian Marcello Lippi beson se Juventus mund të fitojë gjithçka këtë sezon, ndërsa e sheh Napolin si rivalin kryesor të tyre për titull në Serinë A. "Ekziston ndjenja që ky mund të jetë sezoni i duhur për t'i arritur të gjitha. E kam thënë ndër vite se kjo skuadër, e cila është dy herë finaliste e Ligës së Kampionëve, ka arritur nivelin e skuadrave më të forta si Barcelona, Real Madridi dhe Bayern Muncheni. Epo, tani është koha për të thënë se Juventus kryeson në grupin e favoritëve", ka thënë Lippi për "Corriere dello Sport".



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



KUÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04Nr. M/01-34873/2018
Kaçanik, 25.10.2018

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës i lëndës: Gjuhë Gjermane
Institucionet: SHFMU "Qamil Ilazi" Kaçanik i Vjetër, me plotësim norme në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" Kaçanik.


Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs:
Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.
Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim dhe kopjen e letërnjoftimit. Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellet në ditën e intervistimit.

Afati dhe mënyra aplikimit.
Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendër për shërbim me qytetar-Zyra e Pranimit, katë përdhës.
Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.
Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 26.10.018 deri 09.11.2018

Drejtoria drejtorisë
Z. Zahir Doda



Republike e Kosovës
Republika Kosova - Republika of Kosovo


GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË SKENDERAJ
C.nr.75/2017
Me dt.09.10.2018


SH P A L L J E

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve Behlul Spahiu nga fsh.Runik komuna Skenderaj,dhe Gani Spahiu nga Skenderaj të cilët i përfaqëson me autorizim Av.Shefqet Ibrahim i nga Skenderaj, kundër të paditurve, Miliq Sretko Kovaçević, Lubomir Sretko Kovaçević, Jelena Boshko Kovaçević që të gjithë nga fsh.Kosterc komuna Skenderaj tani me vendbanim të panjohur, për vërtetimin pronësie në bazë të nenit 79 pika 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i caktohet përfaqësuesi i përkoshëm Imer Ahmetaj avokat në Skenderaj.


Përfaqësuesi i përkoshëm do të përfaqësojë të paditurit në këtë çështje juridike deri sa ata apo i autorizuari i tyre të paraqitet në këtë gjykatë.

Gjyqtari
Hajrullah Anqsi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



KUÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Direkcija za obrazovanje i kulturu
04Nr. M/01-34873/2018
Kaçanik ,25/10/2018

Na osnovu çlanu 5 (c) Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03 / L-068, çlan 35 Zakona o predškolskom obrazovanju Univerziteta br.04 /L-032, çlana 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 regulaciju procedure konkurencije u javnom sektoru, Administrativnog uputstva MONT-NR10 / 2018 za normativne preko stručnog osoblja opšte obrazovanje, Odeljenje za obrazovanje i kulturu, je izjavio:

O G L A S
Za popunjavanje slobodnog mesta

Radno mesto: Nastavnik; Nemački jezik
Institucije: OSINŠ "Çamil Iljazi" Staro Kaçanik, sadopunjavanje norme u PSS "Feriz Guri i Braća Caka" Kaçanik.


Dužnosti i odgovornosti:

- Izvođenje nastavnih plan i program od značaja za radno mesto, u skladu sa važećim propisima koji regulišu oblasti njegovog / njenog radnog mesta;
- Obavljanje zadataka na poslu osiguravajući kvalitet i profesionalnu kompetentnost nastavnog procesa;
- Pravilno pripremiti nastavni plan i program, u skladu sa jezgrom nastavnog plana i programa.
- Primijeniti nove metodologije nastave i procjene u skladu s smericama kurikuluma;
- Održavanje ličnog studijskog časopisa;
- aktivno učestvuje u vannastavnim aranžmana sa učenicima i studentima da obavljaju odgovorno putovanja u zemlji i inostranstvu, u skladu sa uputstvima direktora škole;
- Poštujte direktnu nadležnost oficira, čiji izveštaji, i obavljaju poslove koji mogu da ga dodelite / nju. Dužnosti rada moraju biti u skladu sa važećim zakonima.

Uslovi učešća na takmičenju:
Za radna mesta navedenih, relevantne profesionalne kvalifikacije zahteva Administrativnog uputstva MONT it.Nr.10 / 2018 pravilo o stručnom obrazovanju okvirnog General.
Kandidati za primenu mora da završi sledeću dokumentaciju: Fakultet diplome, izvod iz matične knjige rođenih, uverenje radnog iskustva u obrazovanju i kopiju lične karte u.
Svi dokumenti tokom prijave moraju biti kopije, dok original treba da se prikaže na dan razgovora.

Rok i način aplikacije.
Prijavni formulari su primljeni i dostavljeni Građanskom servisnom centru - Prihvatilištu, prizemlje.
Nedovršeni dokumenti podnijeti nakon roka neće biti pregledani.
Izbor i kandidati za intervjuë biće obavesteni putem table javnog oglasa.
Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u medijima 26.10.018 do 09.11.2018

Direktor Direkcije
Z. Zahir Doda



Thirrja për aplikim

VALMIRE ZABELI-KOCA B.I po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim: Nderimin e serres moderne me sipërfaqe 5500 m2, me gypa metali te zinguar,foli plastike,shputa betoni etj.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek VALMIRE ZABELI-KOCA nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

- Emri i përfituesit VALMIRE ZABELI - KOCA
- Adresa: Rezalle-Skenderaj
- Tel./fax: 044 / 789 345
- E-mail adresa: lavdi-11@hotmail.com

Ofertat/Propozimet duhen dorëzuar tek adresa e përfituesit me 08/11/2018 [10 ditë pasi që ftesa për Kuotim të jetë dërguar tek të gjithë ofertuesit / kompanitë e interesuara].



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 581/1
Dt: 25.10.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj,
Qendrën e Kompetencës në Skenderaj Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren për vitin
shkollor 2018/2019**

Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	1 (një) Mësimdhënës/e me (16 orë mësimore); për lëndën e Gjuhës Angleze	Vendi i lirë për një (1) vit shkollor
Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh.M.L	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Biznes dhe Ndërmarrësi i (20 orë mësimore); Një (1) mësimdhënës/e për profilin: Arkitekturë (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh.M.L.T	"11 Marsi"	Prizren	Një (1) instruktor të Dizajnit Grafik me 20 orë mësimore Një (1) Mësimdhënës /e lëndëve profesionale të elektroteknikës me mësim në Gjuhën Boshnjake	Vendi i lirë deri në përfundim të vitit shkollor Vendi i lirë me 10 orë (gjysmë norme) deri në përfundim të vitit shkollor

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përpunje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
